REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

01nr400/05-27247
Dt: 16.09.2021

Kryetari i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 11, 13 dhe 58 pika a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03L-040, në pajtim me nenin 13 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me Rekomandimin e Komisionit, për miratimin e kërkesës së z. Shefqet Morina, për mbështetje financiare për organizatën Komunale të Pensionistëve, me datën 16.09.2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet rekomandimi i komisionit që ndërlidhet me kërkesën e z. Shefqet Morina, me numër 01-400/04-18262, të datës 13.07.2021, për mbështetje financiare për ushtrimin e aktiviteteve të organizatës Komunale të Pensionistëve, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Zyrës së Kryetarit të Komunës në vlerë prej 500 €.

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të realizojë procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerën prej 500 € nga mjetet e subvencioneve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe bartjen e tyre në xhirollogarinë me numër [redacted]

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Z. Shefqet Morina
- Arkivit.

Kryetar i Komunës së Gjakovës

për

Ardian Gjini